

VËSHTRIM MBI TREGJET

- Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-qershor 2016
- Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë për periudhën janar-qershor 2016

ZHVILLIME TË TJERA

- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare raporton në Komisionin për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë
- Zhvillohet takimi i përvitshëm midis autoriteteve mbikëqyrëse të Shqipërisë dhe të Austrisë, AMF dhe FMA, për mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve
- Konferencë rajonale për harmonizimin e legjislacionit me *acquis* të BE-së në tregun e kapitalit dhe sistemin e pagesave

EDUKIMI I KONSUMATORIT

- Mbrojtja e konsumatorit në Bashkimin Evropian (pjesa e dytë)

LAJME NDËRKOMBËTARE

- Bullgari ○ Francë ○ Rusi ○ Slloveni

PUBLIKIME

OECD boton “Qeverisja e një rregullatori – të jesh një rregullator i pavarur”
(*The Governance of Regulators -Being an Independent Regulator*)

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-qershor 2016

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit gjatë periudhës janar-qershor 2016 kapën vlerën mbi 6.62 miliardë lekë, ose 2.97% më shumë se gjatë periudhës janar-qershor 2015. Gjatë periudhës janar-qershor 2016, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 481,182 me një ulje prej 1.43% krahasuar me muajin janar 2015.

Një tjetër tregues i ecurisë së tregut, dëmet e paguara bruto, në total, regjistruan një rritje me 29.92% në krahasim me periudhën janar-qershor 2015. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me mbi 1.25 miliardë lekë, apo 66.13% të totalit të dëmeve të paguara bruto.

Sigurimi i Jo-Jetës

Sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 3.29% gjatë periudhës janar-qershor 2016, krahasuar kjo me periudhën janar-qershor 2015.

Sigurimi i detyrueshëm motorik

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të kenë arritur vlerën rreth 3.88 miliardë lekë gjatë periudhës janar-qershor 2016, duke shënuar një rritje prej 6.39% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë periudhës raportuese përbën 58.85% të tregut të sigurimeve.

Klasa të tjera në sigurimet e Jo-Jetës

Ndër klasat e tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës veçohen:

- sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësiive të përgjithshme të cilat së bashku zunë 15.64% të tregut të Jo-Jetës;
- zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë të cilat zunë 15.92 % të tregut të Jo-Jetës.


Sigurimi i Jetës

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u ulën me 4.43% krahasuar me periudhën janar-qershor të vitit 2015. Pjesa më e madhe e primeve të shkruara bruto i përket sigurimit “Jetë debitori” e cila përbën 55.09% të sigurimit të Jetës.

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të kenë arritur vlerën rreth 3.88 miliardë lekë gjatë periudhës janar-qershor 2016, duke shënuar një rritje prej 6.39% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Ndarja e tregut të sigurimeve, janar-qershor 2016

Grafiku më poshtë paraqet ndarjen e volumit total të primeve të shkruara bruto sipas grupeve kryesore.



Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë për periudhën janar-qershor 2016

Volumi i tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë gjatë periudhës janar-qershor 2016 u dominua në masën 74.65% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (bono thesari).

Volumi i tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë gjatë periudhës janar-qershor 2016 u dominua në masën 74.65% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (*bono thesari*) dhe pjesa tjetër prej 25.35% ishin instrumente afatgjatë (*obligacione*). Përsa i përket numrit të transaksioneve, 93.47% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera me bono thesari.

Tregu me Pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë

Lloji i Transaksionit		Vlera nominale (në mln. lekë)		Ndryshimi (në %)
Periudha janar-qershor		2015	2016	'16/'15-1
Letra me Vlerë të Qeverisë				
B	Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar	2,749.94	3,669.58	33.44
	<i>Individë</i>	2,254.09	3,020.23	33.99
	<i>Persona juridikë</i>	495.85	649.35	30.96
C	Blerje para afatit të maturimit	1,347.55	2,017.24	49.70
	<i>Individë</i>	1,274.15	1,535.34	20.50
	<i>Persona juridikë</i>	73.40	481.90	556.54

Transaksioni i llojit C “Blerje para afatit të maturimit” gjatë periudhës janar-qershor 2016 ka pasur një rritje prej 670 milionë lekë ose 49.70% krahasuar me periudhën janar-qershor 2015.

Të dhënat statistikore të **tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë** gjatë periudhës janar-qershor 2016 flasin për një dominim të transaksioneve “*Blerje në tregun primar*” dhe “*Shlyerje e vlerës nominale në maturim*” përkatësisht me 63.01% dhe 20.21% kundrejt volumit të përgjithshëm.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë rreth 99.41% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.


Dy grupet e transaksioneve B dhe C

Transaksioni i llojit **B** “**Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar**” gjatë periudhës janar-qershor 2016, ka pasur një rritje prej 920 milionë lekë ose 33.44% krahasuar me periudhën janar-qershor 2015 dhe numri i transaksioneve është rritur në masën 58.63%.

Transaksioni i llojit **C** “**Blerje para afatit të maturimit**” gjatë periudhës janar-qershor 2016 ka pasur një rritje prej 670 milionë lekë ose 49.70% krahasuar me periudhën janar-qershor 2015 dhe numri i transaksioneve është rritur në masën 30.56%.

Krahasuar me periudhën janar-qershor 2015, vihet re një rritje në vlerë absolute e totalit të transaksioneve të llojit B dhe C të marra së bashku me rreth 1,589 milionë lekë.

Tregu me Pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë



- A. Blerje në tregun primar
- B. Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar
- C. Blerje para afatit të maturimit
- D. Vendosje e bonos si kolateral
- E. Shlyerje e vlerës nominale në maturim

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare raporton në Komisionin për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë

Drejtorja e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), Znj. Enkeleda Shehi, paraqiti më 18 korrik 2016, në Komisionin për Ekonominë dhe Financat, të Kuvendit të Shqipërisë, raportin mbi aktivitetin e institucionit gjatë vitit 2015 dhe zhvillimet e tregjeve financiare që mbikëqyren nga AMF. Në paraqitjen e raportit morën pjesë edhe Kryetari i Bordit të AMF-së Z. Pajtim Melani, si edhe drejtues të tjerë të lartë të Autoritetit.

Në fjalën e saj, Znj. Shehi theksoi se veprimtaria e AMF-së gjatë vitit 2015 u përqendrua në disa drejtime kryesore si:

- Në aspektet e ristrukturimit të AMF-së, në kuadër të zbatimit të ligjit të ri të AMF me konfigurimin e Bordit të ri, miratimin e strukturës së re organizative dhe tabelës re të pagave dhe shpërblimeve;
- Në përgatitjen e akteve nënligjore në zbatim të ligjit të ri të sigurimeve dhe risigurimeve si dhe në përshtatjen e rregulloreve në zbatim të ligjit të ri të AMF;
- Në zbatimin e axhendës së projekteve të asistencës teknike të BB kryesisht në fushën e pensioneve dhe atë të sigurimeve;
- Në plotësimin e rekomandimeve të FSAP-it të cilat shtrihen për të gjitha tregjet që mbikëqyr e rregullon AMF dhe i përkasin një periudhe afatmesme.

Drejtorja e Përgjithshme Znj. Shehi nënvizoi prirjen për zgjerim që patën gjatë vitit 2015 tregu i sigurimeve, letrave me vlerë, fondeve të investimeve dhe fondeve të pensioneve private vullnetare, si tregje financiare që mbikëqyren nga AMF. Sipas vlerësimeve, në vitin 2015 totali i aktiveve në këto tregje arriti në rreth 95.7 miliardë lekë (rreth 697 milionë euro), me një rritje prej 7% kundrejt vitit 2014. Për rrjedhojë, edhe pjesa e aktiveve gjithsej të këtyre tregjeve ndaj PBB-së për vitin 2015 arriti në nivelin më të lartë të vërejtur deri më sot, prej 6.7%.

Në raportim u evidentua edhe bashkëpunimi i AMF-së me organizmat financiarë ndërkombëtarë në realizmin e projekteve të rëndësishme për forcimin e aspekteve mbikëqyrëse dhe rregullative, administrimin e rreziqeve dhe stabilizimin e tregjeve.

Raportimi kishte karakter prezantues mbi veprimtarinë e Autoritetit gjatë vitit 2015. Në një seancë të mëvonshme do të bëhet diskutimi dhe dhënia e përgjigjeve ndaj pyetjeve të shtruara nga deputetët në Komision.

Drejtorja e Përgjithshme Znj. Shehi nënvizoi prirjen për zgjerim që patën gjatë vitit 2015 tregu i sigurimeve, letrave me vlerë, fondeve të investimeve dhe fondeve të pensioneve private vullnetare, si tregje financiare që mbikëqyren nga AMF.

Zhvillohet takimi i përvitshëm midis autoriteteve mbikëqyrëse të Shqipërisë dhe të Austrisë, AMF dhe FMA, për mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve



Drejtues të AMF-së dhe FMA-së Austri, gjatë takimit në Tiranë

Në vijim të bashkëpunimit për çështjet e mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve dhe fondeve të pensioneve private ndërmjet Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) dhe Autoritetit të Tregjeve Financiare të Austrisë (FMA), një delegacion nga ky institucion zhvilloi takime pune në Tiranë në datat 5-7 korrik 2016. Delegacioni kryesohej nga Z. Peter Braumüller, Drejtor Ekzekutiv në FMA, përgjegjës për mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit dhe fondeve të pensionit.

Z. Braumüller, Drejtor Ekzekutiv në FMA, pati takime pune me Znj. Enkeleda Shehi, Drejtore e Përgjithshme Ekzekutive dhe ekspertë të AMF-së. Gjatë takimeve u diskutua për çështje të rëndësishme të interesit të përbashkët. Ndërmjet të tjerash, takimet u përqendruan në zhvillimet kryesore në tregjet e sigurimeve të Austrisë dhe Shqipërisë dhe rezultatet paraprake për shoqëritë e sigurimeve me kapital austriak të pranishme në Shqipëri; zhvillimet ligjore, duke përfshirë edhe zhvillimin e mbikëqyrjes së grupeve, fillimin e mbikëqyrjes me fokus risku që AMF ka filluar që prej vitit 2015, si edhe çështje të tjera. Në takim u diskutua edhe për hapat e mëtejshme të bashkëpunimit midis AMF dhe FMA, si dhe pjesëmarrjen e Shqipërisë në kolegjet mbikëqyrëse, të cilat ndihmojnë në konkretizimin e shkëmbimit të përvojës dhe punën e përbashkët në tregjet në mbikëqyrje.

Të dy institucionet kanë, që prej vitit 2009, një marrëveshje bashkëpunimi, e lidhur menjëherë pas investimeve të grupeve austriake të sigurimeve në Shqipëri, në kuadër të së cilës zhvillojnë takime periodike dypalëshe.

Gjatë takimeve u diskutua për çështje të rëndësishme të interesit të përbashkët. Ndërmjet të tjerash, takimet u përqendruan në zhvillimet kryesore në tregjet e sigurimeve të Austrisë dhe Shqipërisë dhe rezultatet paraprake për shoqëritë e sigurimeve me kapital austriak të pranishme në Shqipëri.

Konferencë rajonale për harmonizimin e legjislacionit me *acquis* të BE-së në tregun e kapitalit dhe sistemin e pagesave

Në 30 qershor 2016 në Shkup, Maqedoni u zhvillua konferenca me temë “Harmonizimi i mëtejshëm me *acquis* të BE-së në fushën e lëvizjes së kapitalit dhe të pagesave, si dhe shërbimeve financiare - tregjeve të titujve dhe shërbimeve të investimit” (*Further harmonization with EU ‘acquis’ in the field of movement of capital and payments and financial services-securities markets and investment services*). Konferenca organizohej në kuadër të Projektit IPA të financuar nga fondet e BE-së. Pjesëmarrës në konferencë ishin rregullatorë të tregut të letrave me vlerë nga i gjithë rajoni dhe përfaqësues të Bankës Kombëtare dhe institucioneve financiare të Maqedonisë.

Harmonizimi i legjislacionit me Direktivat e BE-së synon në një treg modern, eficient dhe produktiv. Një infrastrukturë moderne dhe e harmonizuar rrit besueshmërinë e investitorëve në tregun e kapitalit dhe në shërbimet financiare.

Konferenca ishte e organizuar në dy panele kryesore. Tematika e diskutuar në panelin e parë të konferencës kishte të bënte me Shërbimet e Pagesave. Në këtë panel u diskutua edhe mbi pritshmëritë e konsumatorit në një mjedis dixhital.

Paneli i dytë kishte si temë kryesore Perspektivën Evropiane të Tregjeve të Kapitalit në Rajon. Pjesë e këtij paneli ishte edhe Znj. Enkeleda Shehi, Drejtore e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, krahas përfaqësuesve të rregullatorëve të tregjeve të kapitalit të rajonit si, Kroacia, Sllovenia, Serbia dhe Maqedonia. Në fjalën e saj, Zj. Shehi u përqendrua në punën e bërë nga AMF për përmirësimin e bazës rregullative të tregut të letrave me vlerë dhe veçanërisht të tregut të fondeve të investimeve. Nëpërmjet të dhënave dhe fakteve, auditori u njoh me zhvillimet e tregut shqiptar, dhe njëkohësisht u njoh me projektet e ardhshme.

Pjesëmarrësit në panel diskutuan mbi efektet e mundshme që ka procesi i anëtarësimit, harmonizimi i kuadrit ligjor dhe përfshirja në një bursë rajonale të letrave me vlerë për zhvillimin e tregut të kapitalit në vendet e rajonit. Çështjet, ku u përqendrua diskutimi ishin:

- Përvoja e shteteve të reja, anëtarë të BE-së, dhe efektet e këtij anëtarësimi në tregun e letrave me vlerë;
- Përvoja e secilit vend të rajonit për rritjen e transparencës dhe mbrojtjen e investitorëve;
- Sfidat që vijnë nga procesi i harmonizimit ligjor pas procesit të anëtarësimit në BE;
- Vlerësimet e para pas krijimit të linkut mes 3 bursave të vendeve të rajonit;
- Sfidat e konsolidimit rajonal të tregjeve të kapitalit;
- Tendencat e shkëmbimit ndërkufitar të shërbimeve financiare në rajon.

Harmonizimi i legjislacionit me Direktivat e BE-së synon në një treg modern, eficient dhe produktiv. Një infrastrukturë moderne dhe e harmonizuar rrit besueshmërinë e investitorëve në tregun e kapitalit dhe në shërbimet financiare.

Mbrojtja e konsumatorit, në Bashkimin Evropian (pjesa e dytë)

Politikat e Bashkimit Evropian për mbrojtjen e konsumatorit përfshijnë ndër të tjera kompetencat e Bashkimit Evropian, bazën ligjore dhe përcaktimin e nocionit të konsumatorit. Një analizë në thellësi e kryer nga Shërbimi Kërkimor i Parlamentit Evropian jep një pasqym të politikave për mbrojtjen e konsumatorëve duke u fokusuar në parimet e përgjithshme. Korpusi legjislativ konsiston në 90 direktiva dhe disa rregullime të tjera. Krahas tyre Bashkimi Evropian ka edhe mekanizma të tjerë për të monitoruar dhe përmirësuar mbrojtjen e konsumatorit, studimin e tregut, rritjen e ndërgjegjësimit të publikut, fushatat promovuese, etj.

Dokumenti më poshtë është marrë me shkurtime nga faqja zyrtare online e Parlamentit Evropian [http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/IDAN/2015/565904/EPRS_IDA\(2015\)565904_EN.pdf](http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/IDAN/2015/565904/EPRS_IDA(2015)565904_EN.pdf)



Mbrojtja e konsumatorit ndeshet me sfida të mëdha të cilat janë rrjedhojë e zhvillimeve të reja teknologjike: Modelet e konsumit të ndryshueshme dhe të paqëndrueshme; përjashtimi social në një numër fushash; dhe i ashtuquajti “humori i konsumatorit” i cili mund të jetë shumë i paparashikueshëm.

Mbrojtja e konsumatorit ndeshet me sfida të mëdha të cilat janë rrjedhojë e zhvillimeve të reja teknologjike: Modelet e konsumit të ndryshueshme dhe të paqëndrueshme; përjashtimi social në një numër fushash; dhe i ashtuquajti “humori i konsumatorit” i cili mund të jetë shumë i paparashikueshëm. Megjithatë, sipas një studimi të Parlamentit Evropian, kompletimi i një tregu të vetëm për konsumatorët dhe qytetarët mund të rrisë një potencial prej mbi 300 miliardë euro. Matja sasiore e këtij potenciali mund të ketë edhe rreze, por përfitime të tjera mund të lindin nga lehtësimet e mëtejshme, shtrirja e shërbimeve ndërkufitare, një regjim më efektiv evropian i mbrojtjes së konsumatorit, mbikëqyrje më e mirë e tregut, zbatueshmëria më e mirë e legjislacionit në këto fusha.

Zhvillimi i Politikave - Mbrojtja e konsumatorit dhe prioritetet e Komisionit Evropian

Në kontekstin e krizës ekonomike, axhenda e Komisionit Evropian lidhur me konsumatorin dhe mbrojtjen e tij përcaktoi sektorët e rëndësishëm të veçantë (konkretisht ushqimi, transporti, komunikimet elektronike dhe shërbimet financiare), bazuar në faktin që ata prekin interesat bazë të të gjithë konsumatorëve në mallrat dhe shërbimet thelbësore.

Me qëllim forcimin e sigurisë për konsumatorin, janë identifikuar edhe gjashtë objektiva:

- Përmirësimi i kuadrit rregullator mbi sigurinë e produktit dhe shërbimit dhe forcimi i mbikëqyrjes së tregut;
- Përforsimi i sigurisë në zinxhirin/ linjat e ushqimit;
- Përmirësimi i informacionit dhe rritja e ndërgjegjësimit për të drejtat e konsumatorit, si edhe rritja e interesit si tek konsumatorët ashtu edhe tek tregtarët;
- Ndërtimi i njohurive dhe kapaciteteve për më shumë pjesëmarrje efektive të konsumatorit në treg;



Në Programin e tij të Punës për vitin 2015, Komisioni gjithashtu theksoi se ai do të fillojë punën përgatitore për dhënien e më shumë përfitimeve për konsumatorët nëpërmjet tregut unik për shitjen me pakicë të shërbimeve financiare.

- Zbatimi me efektivitet i ligjit për mbrojtjen e konsumatorin, duke u fokusuar në sektorët kryesorë;
- Gjetja e mënyrave efektive për të zgjidhjen e konflikteve me konsumatorët.

Në Programin e Punës së Komisionit për vitin 2015 jepen disa referenca për konsumatorët:

Në prioritetin për të krijuar një **Treg Dixhital të Lidhur** (*Connected Digital Market*) është vendosur që Komisioni të plotësojë mjedisin rregullator të telekomunikacionit, të modernizojë legjislacionin e BE-së për të drejtat e autorit dhe për shërbimet e mediave audio-vizuale, të thjeshtojë rregullat për konsumatorët që bëjnë blerje *online* dhe dixhitale, të lehtësojë tregtinë elektronike (*e-commerce*) si edhe të përmirësojë sigurinë kibernetike.

Në prioritetin për të siguruar një **Union Fleksibël të Energjisë me një Politikë Progresive për Ndryshimin e Klimës**, është përmendur se Komisioni do të adoptojë një Kuadër Strategjik për Unionin e Energjisë duke parashtruar veprimet kryesore që do të ndërmerren në mënyrë që të arrihet siguria e furnizimit me energji, të zvogëlohet varësia nga importet nga vendet e treta, të integrohen më tej tregjet kombëtare të energjisë dhe të përmirësohet pjesëmarrja e konsumatorit.

Në Programin e tij të Punës për vitin 2015, Komisioni gjithashtu theksoi se ai do të fillojë punën përgatitore për dhënien e më shumë përfitimeve për konsumatorët nëpërmjet tregut unik për shitjen me pakicë të shërbimeve financiare.

Sfida të ardhshme për ekonominë bashkëpunuese

Ekonomia bashkëpunuese ose e përbashkët (e referuar gjithashtu edhe si ekonomia “*peer-to-peer*”, rrjetë, konsum bashkëpunues), bazohet në ndarjen e përbashkët të burimeve fizike dhe njerëzore si krijimtaria, prodhimi, shpërndarja, tregtia dhe konsumi i mallrave dhe shërbimeve. Ajo mund të marrë një llojshmëri formash, duke përdorur përparësitë nga teknologjitë e reja dhe komunitetet e huadhënies së kapitalit (*leveraging communities*) ose të shoqërisë për të dhënë me qira, ndarë, shkëmbyer, ndërruar, tregtuar ose shitur aksesin ndaj produkteve ose shërbimeve. Si i shqetëson kjo individët dhe e ndryshon konceptin e konsumatorit?

Nëpërmjet shfrytëzimit të teknologjive të ndryshme si *open design* dhe *additive manufacturing* (i njohur gjithashtu edhe si printimi 3D), si dhe një ekonomi me burime të hapura, të dhëna të hapura, burime nga populli; kushdo me akses në Internet mund të bëhet një bashkë-krijues i një produkti apo shërbimi. Për shembull, dikush mund të shkarkojë (*download*) një *design* (të një produkti të caktuar), ta përmirësojë atë, të japë porosinë për ta prodhuar këtë *design* dhe ta japë atë si një produkt përfundimtar, dhe e gjithë kjo veprimtari është kryer nga shtëpia. Këto ndryshime sjellin një mori sfidash në lidhje me të ardhmen e rregullave



Paraja dixhitale, si Bitcoin, mund të ndryshojë tendencën e sjelljes së konsumatorit për pagesat online, duke konkurruar me pagesat tradicionale me karta krediti për blerjet online, ndoshta do të nevojiten më shumë rregulla për të rregulluar këtë treg.



për mbrojtjen e konsumatorit. *Sharing economy* i bën të paqartë kufijtë midis profesionistëve, profesionistëve të pavarur dhe të apasionuarve. Duke qenë se një pjesë nga procesi i realizimit të prodhimit realizohet nga vetë konsumatorët, atëherë në mënyrë të pashmangshme lindin pyetje në lidhje me mbulimin me siguracion në rastin e një aksidenti të mundshëm në procesin e “prodhimit të ri” apo për kualifikimin e konsumatorëve pjesëmarrës në këtë ekonomi të re të zhvilluar.

Paraja dixhitale, si *Bitcoin*, mund të ndryshojë tendencën e sjelljes së konsumatorit për pagesat *online*, duke konkurruar me pagesat tradicionale me karta krediti për blerjet *online*, ndoshta do të nevojiten më shumë rregulla për të rregulluar këtë treg. Rregulla do të nevojiten edhe për të vendosur standarde, duke mundësuar uljen më tepër të kostove për transaksionet financiare dhe për të mbrojtur konsumatorët. Krahas mundësisë për rritje dhe rinovim, Interneti dhe këto teknologji të reja japin mundësi të jashtëzakonshme për pjesëmarrjen më të madhe të konsumatorit në shoqëri dhe në ekonomi, pjesëmarrje e cila nevojitet të merret parasysh dhe të shfrytëzohet më tej.

Megjithatë, siguria e konsumatorit duhet të mbetet një shqetësim parësor në këtë aspekt. Në lidhje me këtë, duhet të theksohet që ndarja e shërbimeve si ndarja e shtëpisë apo makinës, të disponueshme nëpërmjet platformave të tilla si Airbnb ose Uber, të cilat tashmë i kanë ulur kostot për konsumatorët dhe u japin atyre mundësi zgjedhje më të gjerë, gjithashtu duket se ngrenë shqetësime për konsumatorët lidhur me boshllëqet e standardeve të sigurisë, pasi konsumatorët nuk mund të mbështeten në të njëjtin nivel të mbrojtjes si në tregun tradicional të shërbimeve, tregu i ekonomisë së ndarë bëhet një zonë gri dhe përgjithësisht e parregulluar.

Bullgari

www.xprimm.com

<http://www.focus-fen.net/news/2016/07/11/409196/more-than-500000-vehicles-in-bulgaria-lack-third-party-liability-insurance.html>

Kryetari i Shoqatës së Viktimave të aksidenteve rrugore në Bullgari Z. Vladimir Todorov duke folur në një radio lokale u shpreh se më shumë se 500,000 automjete në Bullgari nuk kanë bërë sigurimin e detyrueshëm motorik. Ai theksoi se duhet të jemi të kujdesshëm kur lejojmë sigurimet sezonale me një afat prej më pak se një vit edhe pse kjo mund të jetë një mundësi e mirë për drejtuesit e disa tipe mjetesh siç mund të jenë motoçikletat.

Francë

<http://www.xprimm.com/Decision-of-the-Paris-administrative-court-in-favour-of-the-opening-up-of-the-natural-catastrophe-reinsurance-market-in-France-welcomed-by-SCOR-articles-117,124-8187.htm>

Gjykata administrative e Parisit bëri publike këtë javë vendimin e saj në favor të hapjes së tregut të risigurimit nga katastrofat natyrore në Francë. Ky vendim u mirëprit nga SCOR. Vendimi i gjykatës administrative i dha fund monopolit apo siç u cilësua “marrëveshja e garantimit të shtetit për *Caisse Centrale de Reassurance*, për risigurimin nga katastrofat natyrore”.

Grupe të tjera të sigurimit dhe risigurimit në Francë e kanë përshëndetur këtë vendim, si një mundësi për të promovuar hapjen e tregut të risigurimit ndaj katastrofave natyrore në vend. Siç u shprehën ekspertë të grupit SCOR, vendimi i Gjykatës Administrative të Parisit do të çojë në përmirësimin e shërbimit që ofrohet ndaj siguruesve, do të mobilizojë kapacitete shtesë për risigurimin dhe përballimin e katastrofave natyrore, si edhe do të zvogëlojë ekspozimin e buxhetit të shtetit dhe për rrjedhojë edhe të taksapaguesve ndaj ngjarjeve të tilla si katastrofat e madha natyrore.

Qëndrimi i Grupit SCOR reflekton mendimin aktual të industrisë franceze të sigurimeve, që thekson se sistemi e sigurimit nga katastrofat natyrore NatCat duhet të reformohet në mënyrë që të përballojë më mirë sfidat që lindin nga frekuenca e rritur e ndodhjes së katastrofave natyrore si edhe nga intensiteti i tyre.

Një studim i realizuar nga Shoqata Franceze e Sigurimeve me informacionin deri në fund të vitit 2015, sugjeron nevojën e një numri reformash për elementë të sigurimit ndaj katastrofave natyrore në Francë.

Rusi

<http://www.xprim.com/RUSSIA-It-will-be-possible-to-enter-Azerbaijan-from-1-August-by-Green-Card-articol-117,137-8169.htm>

Duke filluar nga 1 gusht 2016 pronarët rus të makinave do të mund të hyjnë në territorin e Azerbajxhanit me certifikatën ruse të sigurimit «Green Card». Marrëveshja përkatëse që lejon përdorimin e kësaj police të sigurimit «Green Card» u nënshkrua nga Unioni Rus i Siguruesve dhe Byroja e sigurimit të detyrueshëm të Republikës së Azerbajxhanit. Në mënyrë të ngjashme, në territorin e Rusisë do të njihen «Green Card» të lëshuara në Azerbajxhan.

Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Këshillit të Byrove në qytetin Sopot (Poloni) më 28 maj 2015, edhe siguruesit e Azerbajxhanit iu bashkuan sistemit Green Card duke filluar nga 1 janar 2016. Ata kanë kompetenca në territorin e vendit me përjashtim të zonës së Nagorno-Karabakut dhe shtatë rajonet përreth, mbi të cilat nuk ka kontroll të qeverisë së Azerbajxhanit.

Sloveni

www.xprim.com

Sipas të dhënave të publikuara nga Shoqata e Sigurimeve të Sllovenisë, në tremujorin e parë të vitit 2016 tregu vendas i sigurimeve arriti në 554 milionë euro ose 1.3% më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Sigurimi Jo-Jetës pati një rritje prej 2.7%, ndërsa sigurimi i Jetës kishte një dinamikë negative me -2.8%.

Dëmet e paguara u rritën me 5.5% gjatë tremujorit të parë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar duke arritur në 351 milion euro. Pjesa më të madhe e dëmeve të paguara ishte e lidhur me sigurimet e Jo-Jetës duke arritur në një vlerë prej 219 milionë euro, ndërsa dëmet e paguara në sigurimin e Jetës arritën në 132 milionë euro.

OECD boton “Qeverisja e një rregullatori – të jesh një rregullator i pavarur”
(*The Governance of Regulators -Being an Independent Regulator*)



Rregullatorët veprojnë në një mjedis kompleks si ndërlidhës midis autoriteteve publike, sektorit privat dhe përdoruesve të fundit. Si “gjyqtarë” që veprojnë në tregjet që ofrojnë ujin, energjinë, transportin, komunikimin dhe shërbimet financiare për qytetarët, ata duhet të balancojnë kërkesat konkurruese dhe nevojat e aktorëve të ndryshëm. Kjo do të thotë se ata duhet të sillen dhe të veprojnë në mënyrë objektive, të paanshme, në vazhdimësi, pa konflikt interesi, paragjykimi apo ndikimit të padrejtë - me fjalë të tjera, në mënyrë të pavarur. Ajo çfarë e dallon një rregullator të pavarur nuk është thjesht struktura institucionale. Pavarësia ushtrohet edhe në gjetjen e ekuilibrit dhe ndikimit të duhur, përmes ndërveprimeve ditore të rregullatorëve me ministritë, industrinë e rregulluar dhe përdoruesit përfundimtarë fundorë. Ky raport identifikon pikat kritike, ku mund të ushtrohet ndikim më i madh, përgjatë momenteve të ndryshme në veprimtarinë e një rregullatori. Ai diskuton gjithashtu disa nga rrugët për zhvillimin e kulturës së pavarësisë, duke përfshirë edhe ndërveprimet me grupet e interesit, personelit dhe financimin.

Për të lexuar më shumë për këtë botim klikoni në http://www.keepeek.com/Digital-Asset-Management/oecd/governance/being-an-independent-regulator_9789264255401-en#page1

The logo for the Albanian Financial Markets Authority (AMF) features the lowercase letters 'amf' in a dark red color, followed by the word 'ALBANIA' in white uppercase letters. The text is set against a light gray background that is divided into two rectangular sections.

amf **ALBANIA**

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al